

NOTE INFORMUESE

Tiranë, më 16.11.2021

Mbi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 %, për jo më gjatë se një vit”, për magjistratin R.K.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka përfunduar hetimin disiplinor, i nisur me iniciativë ndaj magjistratit R.K., me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, pas një ankese të qytetarit N.P., që pretendonte se vendimi gjyqësor ishte arsyetuar dhe zbardhur nga magjistrati në tejkalim të të gjitha afateve procedurale, duke mos i dhënë mundësi atij si paditës, që të ushtronte të drejtën e ankimit në gjykatat më të larta. Qytetari kishte paditur bashkinë Mat për zgjidhje të padrejtë të marrëdhënies së punës.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, provohet se:

- Magjistrati R.K. ka një vonesë prej 5 muaj e një ditë të arsyetimit të vendimit, referuar nga qytetari ankues, (Rrëzim i padisë së N.P. si i pabazuar në prova e ligj), në kapërcim të afatit 20 ditor, të parashikuar në nenin 308, paragrafi i dytë i K.Pr.Civile, afat i cili është tejkaluar plot 6 herë, me një vonesë prej 131 ditë nga shpallja e vendimit përfundimtar, si dhe të afatit 15 ditor të parashikuar nga neni 443, paragrafi i parë i K.Pr.Civile për ushtrimin e të drejtës së ankimit nga palët në proces.
- Nga të gjitha provat e marra gjatë hetimit disiplinor edhe për vendime të tjera të magjistratit, rezulton se mosarsyetimet në kohë të vendimeve gjyqësore janë jo vetëm janë të përsëritura dhe vazhduese, por rezultojnë të jenë gjithashtu dhe të pajustificuar.
- Nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime që përbëjnë një mospërmbushje të rregullt të detyrës, në shkelje të afateve procedurale civile të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke tejkaluar afatet tej çdo llogjike, pavarësisht çështjeve me vështirësi të një niveli mesatar.
- Veprimet e magjistratit R.K. janë kryer të paktën me pakujdesi në formë neglizhence e ardhur edhe si pasojë e ngarkesës, e përsëritur në rastet e analizuara gjatë hetimit. Nuk u provua që këto vonesa të jenë kryer më dashje, me qëllim krijimin e vonesave për palët për të ushtruar ankim ndaj vendimarrjeve të gjyqtarit apo qëllime të tjera.
- Veprimet e magjistratit kanë sjellë si rrezik evident vonesën në ushtrimin e të drejtës së ankimit dhe mundësinë e një drejtësie të mohuar.
- Si pasojë e shkeljes disiplinore të kryer nga ana e magjistratit subjekt hetimi disiplinor është cënuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cënuar besimi i publikut të drejtësisë.

Për sa më sipër, i kërkohet Këshillit të Lartë Gjyqësor pranimi i kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për fillimin e procedimit disiplinor ndaj R.K., me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për shkelje disiplinore të parashikuar nga neni 102, pika 1, shkronja “d” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe dhe caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 % për një periudhë jo më të gjatë se një vit”.